

BIBLIOTEKA

E

814-1

873

SHETI

GJIROKASTI

SPIRO GJIKONDI

*Përmes
viterve*

Vjersha

891.983-1

3

8973

SPIRO GJIKONDI

PERMES VITEVE

(Vjersha)

BIBLIOTEKA E SHETIT
GJIRKASTER

~~55000~~

12593

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MARSHIM.

Përmbi supe pushkët mbanim;
si shqiponja malit ngjanim
ecnim, ecnim, s'ndalnim, s'ndalnim.

Rridhnin djersët, rridhnin ballit.
ecnim shpatesh, majës malit
këmbët shkelnin fije bari.

Qielli nxinte pus i thellë
ne kalonim buzë humnerës
gjoksin vinim përballë erës.

Përmbi krahë çantat hedhur
përmbi brez gjerdanët ngjeshur
shallin qafës, buzëqeshur.

Pushkët mbanim përmbi supe
ecnim, ecnim gjithmonë tutje
drejt agimesh, buzë muzgjesh.

Përmbi ballë yjet ndrinin
Rreze dielli gurrash pinim
shtigjesh ecnim, shtigjesh prinim.

PIANISTES ME UNIFORMË USHTARAKE

Rrëshqisnin gishtat lehtë mbi tastjerë
dhe flokët valaviteshin mbi supe
këpuc' e rëndë pedalin shkelte pa ndërprerë
një marsh i lehtë hapsirën plot e mbushte.

Më ngjante melodia me këngët partizane
me krisma të egra pushkësh në luftime
me vërshëllimë ere, suferine, tramundane
me cicërim'n e zogjve ndër agime.

Ish ulur rreth teje e dëgjonte kompania
pa marrë frymë e sytë nuk t'i shqiste
dhe unë me ty pranë sikur bridhja
betejave kur flaka errësirën digjte.

TË SHTATË

Dëshmorëve të fshatit tim.

Të shtatë pinin ujin e një kroi
sikur të pinin sisën e një nëne
të shtatë pinë ujë Lizikoi
kur morën malet atë mbrëmje.

E egër frynte era që nga malet
dhe retë hidhnin shi e breshër
por shndrisnin yje edhe zjarre
mbi majën e Çukës zhveshur.

Dhe ikën. Eh, sa rrugë brodhën
të shtatë nëpër male e kodra...
diku një valle burrash hodhën
një valle sa u tund toka

diku barkas u shtrinë në llogore
me qytën e pushkës nën faqe
që dimrit të shkrinte dëbora
e maleve të mbijnë manushaqet.

Dimret ishin të akullt, të ngrirë
por zemrat e tyre të ngrohta
dhe, kur mbetën mbi akullin shtrirë
si nënë në gji i mbështolli toka.

Dhe erdhën përsëri në fshat
me yjet e ballit të ndezur
me pushkët hedhur krahëqafë
me bomba e gjerdanë ngjeshur;

në rrjeshta mes shokëve erdhën
duke kënduar një këngë partizane
nëndorit kur fletët po binin
e ujët gjëmonte n'ujvarat.

Të shtatë vijnë shpesh në agime
e ndalen nën hije të rrapit
dhe pleqtë i puthin mbi thinja
të shtatët bij të fshatit.

SIMFONIA E JETËS SONË

Simfonia e jetës
u shkrua në rrugë të hekurta
simfonia e jetës
u shkrua mbi tela tensioni të lartë
buroi nga zemrat e ndezura
në ditët e netët e bukura shqiptare;

simfonia e jetës
buroi nga gurrat popullore
si këngë e moçme kreshnikësh
për ditët e reja plot diell
për fytyrat gazmore të të rinjve
për vitet ngarkuar me epikë;

simfonia e jetës
ushtoi në skena masive
të fushave të gjera me grurë e në male
si ujërat kristalore mes shkëmbinjve
si shkumë e bardhë në diga çentralesh.

U ndie nga skaji në skaj mes luginash
nën gishtat e trashë
të punëtorit, fshatarit
u shpleks si flamur mes suferinash
si mendim i ri
në oxhakun e shtëpisë së re të malësorit.

Simfonia e jetës endet mbi punën
e në këngët për punën
mbi dashurinë e re
e mbi këngët e dashurisë së re
që buçasin nga radiot e altoparlantët
bulevardeve e rrugëve, agimeve e mbrëmjeve. . .

SONJA

Ti, Sonja, po shfleton librat sot
edhe një tufë lulesh mban në dorë,
çantën e ke mbushur plot
me libra, bojë, laps dhe fletore
E buzëqesh si lule

buzëqeshje trëndafili.

Kordelja, lidhur përmbi flokë, ngjyrë qielli.
Ke emocion, e gishtat po të dridhen
për dore më tërheq:

«Më shpejt, xhaxhi, vajti vonë».

Nga era flokët lart të hidhen.

Drejt shkollës ecën

sikur fluturon.

2

Po të përcjell. . .

dhe një mendim ma rrudh sot ballin.

Ti s'më kupton

vërtet nuk ke se si e di.